



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

AD.GJTH.GJL.nr.6/2023

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, duke vepruar sipas kërkesës së Fahrije Jerliu, Leon Jerliu dhe Leart Jerliu që të gjithë nga Kamenica, të cilët i përfaqëson M. J. nga Kamenica, të datës 19.09.2023, për inicimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit B. B. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve diciplinore, me datë 05.10.2023, morri këtë:

**AKTVENDIM**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e F. J., L. J. dhe L. J. e datës 19.09.2023, për inicimin e procedurës disiplinore, të paraqitur ndaj gjyqtarit B. B. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan.

**ARSYETIM**

Ankuesit me datë 19.09.2023, në Gjykatën Themelore në Gjilan, kanë dorëzuar një ankesë, të cilën e kanë dërguar edhe në e-mail elektronik, me të cilën kanë pretenduar se gjyqtari B. B., ka bërë shkelje diciplinore të parapara në nenin 5 par 1, pika 1.2 dhe par.2, pika 2.1 dhe 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ashtu që me Aktgjykimin C.nr. 252/17 të datës 14.08.2023, e refuzon kërkesëpadinë si të pabazuar, duke i obliguar që të i paguajnë shpenzimet e procedurës. Në ankesë, ankuesit pretendojnë që nga viti 2015 kanë kërkuar kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga marrëveshja e qiradhënisë dhe se gjyqtari nuk i ka marrë në administrim provat të cilat gjendet në shkresat e

lëndës lidhur me borxhet e tjera të tē paditurit dhe se për këto arsyen aktgjykimi është i paqëndrueshëm, ashtu që edhe sipas bazës juridike të thirrur nga gjykata sipas LMD-ës tē vitit 1978, ato nene nuk janë në fuqi dhe se gjyqtari ka bërë konstatim tē gabuar tē gjendjes faktike.

Kryetari i gjykatës, pas analizimit tē pretendimeve tē palës ankuese, ka gjetur se e kërkesa është e pabazuar.

Kryetari i gjykatës, vlerëson se pretendimet e palës ankuese, nuk kanë tē bëjnë me shkelje diciplinore tē gjyqtarit. Gjyqtari i çështjes, ka vendosur në mënyrë meritore lidhur me çështjen kontestuese tē paditësve, tani palë ankuese dhe se pretendimet e tillë tē ngritura në këtë ankesë, nuk përbëjnë shkelje diciplinore tē gjyqtarit, i cili ka vendosur në kuadër tē kompetencave tē tij, ashtu që pretendimet në ankesën parashtruar Kryetarit tē gjykatës, mund tē shqyrtohen nga Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nëse paraqitet mjeti adekuat juridik pranë kësaj gjykate.

Përfundimisht, kryetari i gjykatës ka gjetur se nuk është përbushur asnjëra nga pikat e parapara në nenin 5 paragrafi tē Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Gjyqtar, andaj konform nenit 9 paragrafi 6 tē po tē njëjtligj pasi që ka gjetur se ankesa është dukshëm joserioze dhe e pabazuar, ka vendosur si në dispozitiv tē këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës

Venhar Salihu  
  
REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF JUSTICE  
GENERAL ATTORNEY'S OFFICE  
GENERAL ATTORNEY

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit tē kërkesës
2. Gjyqtarit tē çështjes
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.